



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 665/ 8 prot.

Datë 07.05.2024

V E N D I M
Nr. 453/2024

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 07.05.2024 shqyrtoi ankesën me:

Objekt: Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me vlerësimin me pikë të propozimeve teknike të paraqitura nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “*L.T.E Construction*” SHPK & “*Varaku E*” SHPK në procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur*”, me Nr. REF-92191-12-27-2023, me objekt “*Rehabilitimi i rrugëve në lagjen Metallaj, Karpen, Bodinok Nj. Ad Maminas*” me fond limit: 55.343.180 (pesëdhjetë e pesë milion e treqind e dyzetë e tre mijë e njëqind e tetëdhjetë) lekë pa TVSH, parashikuar për tu zhvilluar në datën 19.01.2024 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Shijak.

Ankimues: Bashkimi i operatorëve ekonomikë “*L.T.E Construction*” SHPK & “*Varaku E*” SHPK, me NIPT L78006801F dhe NIPT J61902509S, me adresa: Rruga “3 Dëshmorët”, godinë banimi dhe shërbimi 11 kate, Kashar, Tiranë.

Autoriteti Kontraktor: Bashkia Shijak
Adresa: Lagja “Erzen” Shijak.

Subjekt i interesuar: Operatori ekonomik “HTM” SHPK & “Vildev-Co” SHPK, me NIPT K97006004D dhe NIPT K83926001F, me adresë Lagjja “Perash”, Rruga “Rrojej”, Nr 44, Shkodër dhe Lagjja 17, Rruga “Riza Mançe”, Nr.21, Korçë.

Baza Ligjore:

Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V ë r e n:**I***Vlerësimi paraprak*

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga tre anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II*Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 28.12.2023, në Sistemin e Prokurimeve Elektronike është publikuar procedura e prokurimit “Procedurë e hapur”, me Nr. REF-92191-12-27-2023, me objekt “Rehabilitimi i rrugëve në lagjen Metallaj, Karpen, Bodinok Nj. Ad Maminas” me fond limit: 55.343.180 (pesëdhjetë e pesë milion e treqind e dyzetë e tre mijë e njëqind e tetëdhjetë) lekë pa TVSH, parashikuar për tu zhvilluar në datën 19.01.2024 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Shijak.

II.2. Në datën 19.01.2024, autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.3. Në datën 28.02.2024, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

- | | | |
|--|--------|--------------|
| 1. “Rrugë Sinjalistikë Mirëmbajtje & Hidro Company” dhsh | 0 Pikë | skualifikuar |
| 2. “Pepa Group” SHPK | 0 Pikë | skualifikuar |
| 3. “Bami Holding” SHPK | 0 Pikë | skualifikuar |

4. “L.T.E Construction” SHPK & “Varaku E” SHPK kualifikuar

Anëtari i KVO-së:	Oferta ekonomike	Pikët për cmimin në %	Pikët për Grafikun në %	Pikët për cilësinë në %
1	51.823.332,23	94	80	100
2	51.823.332,23	94	80	100
3	51.823.332,23	94	80	100

5. “HTM” SHPK & “Vildev Co” SHPK kualifikuar

Anëtari i KVO-së:	Oferta ekonomike	Pikët për cmimin në %	Pikët për Grafikun në %	Pikët për cilësinë në %
1	54.450.706	97	100	100
2	54.450.706	97	100	100
3	54.450.706	97	100	100

II.4. Në datën 28.02.2024, bashkimi i operatorëve ekonomikë “L.T.E Construction” SHPK & “Varaku E” SHPK është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave, si dhe kualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi.

II.5. Në datën 13.03.2024, autoriteti kontraktor ka publikuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik “Publikimi i Njoftimit të Fituesit Paraprak” për procedurën e prokurimit objektivisht.

II.6. Në datën 19.03.2024 nëpërmjetë sistemit të ankesave elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor, është dorëzuar ankesa me nr. A/2024/3910 dhe me nr. 655/2024 prot, datë 19.03.2024 e operatorit ekonomik “L.T.E Construction” SHPK & “Varaku E” SHPK, ku u konstatua, se objekti i saj lidhet me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, mbi vlerësimin me pikë të propozimeve teknike të paraqitura nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “L.T.E Construction” SHPK & “Varaku E” SHPK me përmbajtje si vijon:

Në datën 28.12.2023 në Sistemin e Prokurimeve Elektronike është publikuar procedura e prokurimit E hapur me nr.REF-92191-12-27-2023 me objekt Rehabilitimi i rrugeve ne Lagjen Metallaj, Karpen, Bodinok Nj.Ad Maminas dhe fond limit 55.343.180 (pesedhejte e pese milion

e treqind e dyzete e tre mije e njegind e tetedhjetë) lekë pa TVSH. Zhvilluar nga AK me date 19.01.2024 ora 10:00.

Me date 28.02.2024 jemi njoftuar ne SPE mbi vleresimin e Komisionit te Vleresimit te Ofertave mbi piket e vendosura si vijon;

<i>Operatori Ekonomik</i>	<i>Piket e Vendosura</i>	<i>Refuzuar</i>
<i>HTM</i>	<i>294.60</i>	<i>Jo</i>
<i>LTE</i>	<i>271.20</i>	<i>Jo</i>
<i>Bami Holding</i>	<i>0</i>	<i>Po</i>
<i>Pepa Group</i>	<i>0</i>	<i>Po</i>
<i>RSM COMPANY</i>	<i>0</i>	<i>Po</i>

Ne daten 13.03.2024 ka ardhur ne spe njoftimi 'Afati per ankimim per tenderin: Rehabilitimi i rrugeve ne Lagjen Metallaj, Karpen, Bodinok Nj.Ad Maminas ka nisur.

Ne daten 18.03.2024 jemi vene ne dijeni nga Buletini Nr. 15 i dates 18.03.2024 ne lidhje njoftimin e fituesit per BOE HTM nr Nipt K97006004D dhe "VILDEV-CO" nr NIPT K83926001F si vijon;

Kriteret e perzgjedhjes se fituesit: oferta ekonomikisht me e favorshme bazuar ne kosto X cmimi me i ulët pikët 0 – 60; Koha e zbatimit te kontrates, grafiku i zbatimit pikët 0 – 30; Cilesia pikët 0-10.

1. BOE HTM nr Nipt K97006004D dhe "VILDEV-CO" nr NIPT K83926001F Vlera 54.450.706 (pesëdhjetë e kater milion e katerqind e pesëdhjetë mije e shtateqind e gjashtë) leke pa TVSH dhe 294,60 pike.

2. BOE L.T.E CONSTRUCTION sh.p.k nr Nipt L78006801F dhe VARAKU-E sh.p.k me nr Nipt J61902509S Vlera 51.823.332,23 (pesëdhjetë e nje milion e tetëqind e njetë e tre mije e treqind e tridhjetë e dy presje njetë e tre) leke pa TVSH dhe 271,20 pike.

3. BAMI HOLDING me nr Nipt J94416206R Vlera 45.070.220,48 (dyzete e pese milion e statedhjetë mije e dyqind e njetë e presje dyzete e tete) leke pa TVSH, nuk gjenerohen pike pasi eshte i skualifikuar.

4. PEPA GROUP me nr Nipt L42215009L Vlera 42.164.787 (dyzete e dy milion e njetëqind e gashtedhjetë e kater mije e shtateqind e shtatedhjetë e tete) lekë pa TVSH, nuk gjenerohen pike pasi eshte i skualifikuar.

5. RSM COMPANY me nr Nipt L04803001U Vlera 40.481.805 (dyzete milion e katerqind e tetedhjetë e nje mije e tetëqind e pese) leke pa TVSH, nuk gjenerohen pike pasi eshte i skualifikuar.

Nga pjesemarrësit jane skualifikuar Ofertuesit e meposhtem: BAMI HOLDING, PEPA GROUP, RSM COMPANY.

Ankesa jone eshte ne perputhje me nenin Neni 97 Afatet per paraqitjen e ankesave te RRPP.

Ne rastin e ankesave per vendimin e vleresimit/klasifikimit perfundimtar, operatorët ekonomike mund te ankohen pran autoritetit/entit kontraktor:

brenda 10 (dhjete) diteve nga publikimi i njoftimit te fituesit, ose publikimi i njoftimi te anullimit, ne procedurat e prokurimit mbi kufirin e larte monetar; b) brenda 7 (shtate) diteve nga publikimi injoftimit te fituesit, ose publikimi i njoftimi te anulimit, ne procedurat e prokurimit nen kufirin e larte monetar.

Ne anje nga menytrat enjoftimit ne sistemin e SPE dhe Buletinin e Prokurimeve Publike AK Bashkia Shijak nuk na ka vene ne dispozicion metodologjine e ndjekur nga anëtarët e komisionit te vleresimit te ofertave mbi perlllogaritjen e pikeve per secilin kriter, duke i mohuar nje te drejte themeltare OE ankimues. Edhe pse nuk jemi njohur per metodologjine e ndjekur nga KVO prane autoritetit kontraktor mbi perlllogaritjen e pikeve, serisht e kundershtojme kete ankese persa me poshte vijon;

Në nenin 41 te ligjit 162/2020 "Për Prokurmin Publik është parashikuar: "Autoriteti ose enti kontraktor ne percaktimin e fituesve te kontratave publike zbaton procedurat e parashikuara ne këte ligj. Llojet e procedurave te prokurimit publik jane: a) procedure e hapur; b) procedure e kufizuar; c) procedure konkurruese me negociim, e cila perdoret vetem ne rastin e kontratave te sektorit klasik; ç) partneritet per inovacion; d) dialogu konkurrues; dh) procedure me negociim me shpallje paraprake te njoftimit, e cila perdoret vetem ne rastin e kontratave sektoriale; e) procedure me negociim pa shpallje paraprake te njoftimit te kontrates; e) procedure e hapur e thjeshtuar; f) sherbim konsulence."

2. Per prokurimet me vlere nen kufirin e ulët monetar te mallrave, sherbimeve apo punëve, autoriteti kontraktor mund te perdore procedura te thjeshtuara, te percaktuara ne rregullat e prokurimit publik."

Në nenin 45 të VKM Nr. 285 date 19.05.2021 "Per miratimin e rregullave te Prokurimit Publik ishte parashikuar:

Kriteret per shpalljen e ofertes fituese

1. Autoriteti/enti kontraktor percakton dhenien e kontratave publike bazuar në oferten ekonomikisht me te favorshme.
2. Oferta, ekonomikisht me e favorshme, identifikohet ne baze te cmimit ose kosos, duke perdorur metoden e efektivitetit te kosos, siç jane kosot gjate ciklit jetesor, ne perputhje me nenet 87 dhe 88 te LPP-se dhe mund të bazohet ne raportin me te mire cmim-cilesi, qe versohet mbi bazen e kriterëve që lidhen me objektin e kontrates ne fjale, duke perfshire cilesine, aspektet mjedisore dhe/ose sociale.
3. Per punët/mallrat/sherbimet qe kane specifikime te thjeshta, standarde teknike te mirënjohura dhe jane lehtesisht te gjendura ne treg, oferta ekonomikisht me e favorshme, bazohet ne cmimin si i vetmi element i ndryshueshem ndermjet ofertave.
4. Ne kontratat qe pervec cmimit per punen/mallin/sherbimin, objekt i kontrates, permban dhe elemente te tjera, që kane vlere ekonomike dhe i ngarkojnë autoritetit/entit kontraktor shpenzime gjate fazes se zbatimit te saj ose dhe me tej, kriteri i ofertes ekonomikisht me te favorshme bazohet ne:
 - a) cilësine, duke perfshire meritat teknike, karakteristikat estetike dhe funksionale, aksesueshmerine, projektimin per te gjithë perdoruesit, karakteristikat mjedisore dhe novatore, si dhe tregtimin dhe kushtet e tij; dhe/ose

b) organizimin, kualifikimin dhe përvijën e stafit që është emëruar për të zbatuar kontratën, kur cilësia e stafit të emëruar mund të ketë një ndikim domethënës në nivelin e zbatimit të kontratës; dhe/ose

c) shërbimin koston pas shitjes dhe asistencën teknike, kushtet e dorëzimit, si p.sh. datën e dorëzimit, procesin e dorëzimit dhe periudhën e dorëzimit ose periudhën e përfundimit.

5. Kriteret për shpalljen e kontratës fituese konsiderohen se janë të lidhura me objektin e kontratës, kur ato lidhen me punët, furnizimet ose shërbimet që do të ofrohen në zbatim të asaj kontrate në çdo drejtim dhe në çdo fazë të ciklit të tyre jetësor, duke përfshirë faktorët që bëjnë pjesë në:

1. procesin specifik të prodhimit, ofrimit ose tregtimit të atyre punëve, furnizimeve ose shërbimeve; ose
2. një proces specifik, për një fazë tjetër të ciklit të tyre jetësor, edhe kur këta faktorë nuk janë pjesë e substancës së tyre thelbësore.

6. Kriteret për shpalljen e kontratës fituese garantonë mundësinë e konkurrencës efektive dhe shfaqen nga specifikime, të cilat lejone që informacionet e dhëna nga ofertuesit, të verifikohen, për të vlerësuar nëse ofertat përmbushin kriteret për shpalljen e kontratës fituese. Në rast dyshimi, autoriteti/enti kontraktor verifikon saktësinë e informacionit dhe provat e paragjitura nga ofertuesit.

7. Autoriteti/enti kontraktor specifikon në dokumentet e tenderit shkallën e rëndësisë relative që i jep çdo kriteri të zgjedhur për të përcaktuar ofertën ekonomikisht më të favorshme, me përjashtim të rasteve kur kjo identifikohet vetëm mbi bazën e cmimit.

8. Të gjitha kriteret e vendosura për vlerësimin e ofertave duhet të jenë sa më objektive dhe të shprehesh në shifra. Në çdo rast, kur kriteret janë më shumë se një, pesha e kriterit të cmimit nuk do të jetë më pak se 50 pike. Pikët maksimale që do të marrë një ofertë do të jenë 100 pike. Për kriteret vlerësuese duhet përcaktuar pesha specifike e secilit kriter dhe konkretisht pikët që do të ketë çdo kriter dhe menja e llogaritjes së pikeve për ofertuesit e njëpasnjëshëm. Formula që zbatohet në këtë rast parashikohet në dokumentet standarde të tenderit.

Ky nen nuk është përmbushur nga KVO në vlerësimin me pike të Operatoreve.

Në pikën 4.4 të dst, 4.4 Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

A) Oferta ekonomikisht më e favorshme, bazuar në koston X

Sipas rëndësisë:

pikët 0- 60 cmimi me i ulët

Operatori ekonomik duhet të përshkruajë ofertën

Koha e zbatimit të kontratës, grafiku i zbatimit pikët 0-30

Operatori ekonomik duhet të tregojë aftësinë për të transformuar kërkesat e specifikimeve teknike dhe kostot në plan pune konkret, me gëllim për të realizuar shërbimet sipas afatit pikët 0-10

Treguesit dhe analize cilësore në punë duke përcaktuar elementet e saj.

Autoriteti/ Enti Kontraktor duhet të specifikojë pikët për secilin kriter të përcaktuar të vlerësimit.

Se pari; fillimisht, verehet se veprimi administrativ i KVO dhe autoritetit kontraktor për mosnjohimin e OE ankimes mbi specifikën e ndjekur për pikezimin për secilin kriter të ofertes sone bie ndesh dhe me vet parashikimet e AK në DST.

Se dyti, duke u nisur nga kriteret e parashikuara në DST në përzgjedhjen e fituesit, në cmojmë se vlerësimi i ofertes së paraqitur prej nesh bie ndesh me kriteret e parashikuara në DST.

A) Lidhur me kriterin çmimi me i ulet rezultoi se shoqëria jone ka dorëzuar një ofertë ekonomike me të leverdishme për autoritetin kontraktor se ajo e shoqërisë HTM shpk, e për rrjedhojë shoqëria jone lidhur me këto kriter duhet të marrë pikezimin maksimal 60 pike.

B) Për sa i përket kriterit "Koha e zbatimit të kontratës, grafiku i zbatimit Operatori ekonomik duhet të tregojë aftësinë për të transformuar kërkesat e specifikimeve teknike dhe kostot në plan pune konkret, me qëllim për të realizuar shërbimet sipas afatit." mendojmë se vlerësimi i kryer nga KVO është subjektiv dhe i pabazuar pasi nga ana e BOE është dorëzuar Dokumenti Teknik Grafiku i punimeve dhe Metodologjia në të cilën janë detajuar kërkesat e specifikimeve teknike dhe kostot në plan pune konkret, me qëllim për të realizuar shërbimet sipas afatit sipas rubrikave si më poshtë për këto pike shoqëria jone duhet të marrë piket maksimale 30 pike;

1. Koha e Mobilizimit në Kantier

2. Ngritja e Kantierit

3. Staf i Teknik

4. Faza II - Grafiku i Realizimit të Punimeve;

5. Piketimi i Zonave ku Zhvillohet Projekti.

6. Plani i Menaxhimit të Trafikut.

7. Grafiku i Punimeve

8. Testet Laboratorike dhe Kontrolli i Cilesise

9. Organigrama e Përgjithshme e B.O.E LTE Construction & Varaku E Shpk

Në lidhje me kriterin Cilesia Treguesit dhe analize cilësore në punë duke përcaktuar elementët e saj ashtu edhe në ftesën për ofertë autoriteti kontraktor ka përcaktuar se vlerësimi do të kryhet mbi treguesit dhe analiza cilësore në punë duke përcaktuar elementet e saj. Konkretisht nga analizimi i metodologjisë së dorëzuar nga ana e BOE LTE VARAKU, rezultoi se prima facia metodologjia e propozuar përmban të gjithë elementet e kërkuar nga ana e autoritetit kontraktor.

C) Nga ana tjetër, në mënyrë kryesive të cuditshme nga ana e autoritetit kontraktor nuk është dhënë asnjë shpjegim teknik mbi arsyen e vlerësimit me shumë më pak pike se kufiri maksimal i vendosur në DT. Metodologjia e propozuar nga ana e operatorit ekonomik përbëhet nga;

1. Cilesia Treguesit dhe Analize Cilësore në Punë duke Përcaktuar Elementet e saj.

2. Testet Laboratorike dhe Kontrollit Cilesise

3. Monitorimi i Mjedisit

4. Plani i Menaxhimit Mjedisor

5. Plani i Menaxhimit të Mbetjeve

6. Masat për Sigurimin dhe Instruktimin Teknik të Punonjesve.

Nga seksionet e mësipërme, tre nga të cilat përmbajnë të dhëna të detajuara teknike dhe përmirësim të ndjeshëm të termave të referencës në drejtim të sigurimit teknik në punë dhe

mbrojtjes nga mjedisi, metodologjine e punimeve, kushtet teknike te zbatimit te punimeve dhe planimit te menaxhimit te sigusie dhe shendetit ne pune. Edhe per kete kriter duhet te vleresohemi me piket maksimale 10 pike, (Bashkengjitur kesaj Ankese do te jene Grafiku i Punimeve dhe Metodologjia si edhe Cilesia dhe metodologjia te hedhur ne fazen e tenderit.

Per sa me siper Vendimi per te shpallur fituesin (HTM shpk) per proceduren e sipermendur nga ana e KVO eshte bere ne kundërshtim me ligjin, rregullat e prokurimit publik dhe dokumentat standarte te tenderit, nuk eshte bere transparencë se mbi çbaze dhe kriteresh jane vleresuar ofertat.

Kerkojme te shfuqizohet vendimi i meparshem dhe te ndryshohet Vleresimi me pike pasi BOE LTE dhe VARAKU E disponon te gjithë kapacitetet e nevojshme te shprehura ne Grafikon dhe Cilesine e punimeve, gjithashtu edhe si oferta me e mire ne cmim duke kursyer Bashkise Shijak 2.627.374 lek pa tvsh nga buxheti i saj. Kerkojme Veresimin me pike te plota per BOE LTE dhe VARAKU.

II.7. Bazuar në nenin 112 pika 3 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik” Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe formularin për publikim Nr. 665/2 prot., datë 20.03.2024, me pretendimet e bashkimit të operatorëve ekonomikë “L.T.E Construction” SHPK & “Varaku E” SHPK kundërshton me anë të ankesës me nr. 665 prot, datë 19.03.2024.

II.8. Nëpërmjet shkresës me nr. 1274/1 prot., datë 21.03.2024, protokolluar me tonën me shkresën nr. 665/3 prot., datë 25.03.2024 me objekt “Dërgim i Vendit Nr. 76, datë 21.03.2024”, është depozituar nga autoriteti kontraktor akti i trajtimit të ankesës së bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues, ku konstatohet, se autoriteti kontraktor ka vendosur mos pranimin e ankesës.

II.9. Me shkresën Nr. 665/4 prot., datë 19.04.2024 me objekt “Mbi detyrimin e autoritetit kontraktor për dhënie informacioni KPP-së lidhur me ankesën e bashkimit të operatorit ekonomik “L.T.E Construction” SHPK & “Varaku E” SHPK”, KPP iu drejtua autoritetit kontraktor, Bashkia Shijak, duke i kërkuar autoritetit kontraktor të dërgojë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, procesverbalit të mbajtur të vlerësimit të ofertave nga Komisioni Vlerësimit të Ofertave në mënyrë të detajuar për secilën ofertë pjesëmarrëse, me qëllim sqarimin e mënyrës e vlerësimit me pikë të ofertuesve.

II.10. Me shkresën nr. 1670/1 prot, datë 25.04.2024 protokolluar me tonën me nr. 665/5 prot datë 26.04.2024, autoriteti kontraktor ka vënë në dispozicion të Komisionit të Prokurimit Publik procesverbalin e vlerësimit të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi si me poshtë vijon:

Për dy operatorët e ekonomikë të kualifikuar metoda e përlogaritjes së çmimit është bërë referuar Ligjit Prokurimit Publik nr. 163 datë 23.12.2020, i ndryshuar dhe VKM-së nr. 285 datë 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar.

Nga BOE L.T.E Construction shpk nr. Nipt L78006801F dhe Varaku-E shpk me nr Nipti J61902509S është ofertuar vlera prej 51.823.332,23 lekë pa TVSH.

Dhe Grafiku i punimeve me afat 5 muaj.

Nga KVO është bërë përlogaritja e pikëve sipas kritereve të përcaktuara

1. Cmimi më i ulët - 60 pikë

2. Grafiku i zbatimit - 30 pikë

3. Cilësia - 10 pikë

*$PK1 = V_{minK1} * P_{maxK1} / Ok1$*

$PK1 =$ Pikët e kriterit që vlerësohen

$PK2 =$ Koha e zbatimit të kontratës

$Pk3 =$ Cilësia

$V_{minK1} =$ Vlera më e ulët e kriterit që vlerësohet

$P_{maxK1} =$ Piket maksimale të kriterit që vlerësohet

$Ok1 =$ Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet

$V_{maxK1} = 51.823.332,23$

$P_{maxK1} = 60$ pikë

$Ok1 = 51.823.332,23$ lekë

*$Pk1 =$ vlera më e ulët e kriterit që ofertohet $51.823.332,23 * 60$ pikë / $51.823.332,23$ i ofertës së ofertuar = 60 pikë*

*$Pk2 =$ vlera më e ulët e grafikut të ofertuar $4 * 30$ pikë / 5 afati i grafikut të ofertuar = 24 pikë*

*$Pk3 = 10 * 10 / 10 = 10$ pikë*

Për sa i përket cilësisë së punimeve KVO vendosi se sipas deklarimeve në SPE, të ofertuar ti vlerësojë OE pjesëmarrës me 10 pikë

Në total 94 pikë

Vlerësimi në sistem përkthehen pikët në peshë për një anëtar të KVO sipas rastit:

BOE L.T.E CONSTRUCTION sh.p.k dhe VARAKU-E sh.p.k

*Për Cmimin $60 * 100 / 60 = 100$*

*Për Grafikon $24 * 100 / 30 = 80$*

*Për cilësinë $10 * 100 / 10 = 100$*

Nga BOE HTM sh.p.k nr Nipt K97006004D dhe “VILDEV-CO” sh.p.k nr NIPT K83926001F është oferuar vlera prej 54.450.706 leke pa TVSH.

Dhe Grafiku i punimeve me afat 4 muaj.

Nga KVO është bërë përlogaritja e pikëve sipas kritereve të përcaktuara

1. Cmimi më i ulët - 60 pikë

2. Grafiku i zbatimit - 30 pikë

3. Cilësia - 10 pikë

$PK1 = Vmink1 * Pmaxk1 / Ok1$

$PK1 =$ Pikët e kriterit që vlerësohen

$PK2 =$ Koha e zbatimit të kontratës

$Pk3 =$ Cilësia

$VminK1 =$ Vlera më e ulët e kriterit që vlerësohet

$Pmaxk1 =$ Pikët maksimale të kriterit që vlerësohet

$OK1 =$ Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet

$Vmaxk1 = 54.450.706$

$Pmaxk1 = 60$ pikë

$Ok1 = 51.823.332,23$ lekë

$PK1 =$ vlera më e ulët e kriterit që ofertohej $51.823.332,23 * 60$ pikë / $54.450.706$ i ofertës së ofertuar = $57,1$ ose e rrumbullakosur në 57 pikë

$PK2 =$ vlera më e ulët e grafikut të ofertuar $4 * 30$ pik / 4 afati i grafikut të ofertuar = 30 pikë

$Pk3 = 10 * 10 / 10 = 10$ pikë

Për sa i përket cilësisë së punimeve KVO vendosi se sipas deklarimeve në SPE të ofertuar ti vlerësojë OE pjesëmarrës me 10 pikë.

Në total 97 pikë

Vlerësimi në sistem përkthehen pikët në peshë për një anëtar të KVO sipas rastit:

BOE HTM sh.p.k nr Nipt K97006004D dhe "VILDEV-CO" sh.p.k

Për Cmimin $57 * 100 / 60 = 95$

Për Grafikun $30 * 100 / 30 = 100$

Për Cilësinë $10 * 100 / 10 = 100$

Për tre OE të skualifikuar nuk përllogariten pikët pasi nuk plotësojnë kriteret e kërkuara në DST nga NJP.

KVO më datë 28.02.2024 ka kërkuar dorëzimin e dokumentacionit fizik për BOE 1. BOE HTM sh.p.k nr Nipt K97006004D dhe "VILDEV-CO" sh.p.k nr NIPT K83926001F.

I cili më datë 04.03.2024 ka dorëzuar pranë zyrës së protokoll/arshivës në Bashki. Komisioni i vlerësimit të Ofertave shqyrtoi dosjen fizike për BOE dhe më pas bëri vlerësimin e ofertave bazuar në metodën e vlerësimit të përcaktuar në DST, njoftimi i kontratës. Komisioni autorizoi Njësinë e Prokurimit që të vazhdojë procedurën në sistemin elektronik me njoftimin e klasifikimit për Njoftimin e fituesit paraprak, i cili u bë më datë 12.03.2024. Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 110 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", dhe procedura vijon hapat e tjerë nga Njësia e Prokurimit pranë bashkisë.

II.11. Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosjen e shqyrtimit administrativ, si dhe bazuar në informacionin e Autoritetit Kontraktor, u konstatua se nuk ka pasur pretendime nga subjekte të interesuara, në përputhje me nenin 113 të ligjit Nr.162/2020 "Për Prokurimin Publik".

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor dhe verifikimeve të kryera,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimet e bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues “L.T.E Construction” SHPK & “Varaku - E” SHPK me argumentin se: “Për sa më sipër vendimi për të shpallur fituesin (HTM shpk) për procedurën e sipërmendur nga ana e KVO është bërë në kundërshtim me ligjin, rregullat e prokurimit publik dhe dokumentat standarte të tenderit. Kërkojmë të shfuqizohet vendimi i mëparshëm dhe të ndryshohet vlerësimi me pikë pasi BOE LTE dhe VARAKU-E disponon të gjithë kapacitetet e nevojshme të shprehura në Grafikon dhe Cilësinë e punimeve, gjithashtu edhe si oferta më e mirë në cmim duke kursyer Bashkisë Shijak 2.627.374 lekë pa tvsh nga buxheti i saj. Kërkojmë vlerësimin me pikë të plota për BOE LTE dhe VARAKU-E”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

II.1.1. Në dokumentat e tenderit, kreu I “Udhëzime për operatorët ekonomikë”, pika 21 “Kriteret e përcaktimit të ofertës fituese”, parashikon:

Oferta Ekonomikisht më e Favorshme, bazuar në kosto :

Lidhur me kriteret e vlerësimit, duhet përcaktuar qartë pesha specifike e secilit kriter, përkatësisht numri i pikëve për secilin kriter dhe mënyra se si do të llogariten pikët për ofertuesit e njëpasnjëshëm.

Të gjitha kriteret e vendosura për vlerësimin e ofertave janë objektive dhe shprehen në shifra. Në çdo rast, kur ka më shumë se një kriter, pesha specifike e kriterit të çmimit nuk duhet të jetë më pak se 50 pikë. Pikët maksimale që mund të marrë një Ofertë do të jenë 100.

Formula me të cilën llogariten pikët e ofertuesve, në çdo rast duhet të jetë:

$$Po = Pk1 + Pk2 + Pk3 + \dots$$

Ku:

Po - janë pikët totale të ofertës së vlerësuar

$Pk1/Pk2/Pk3/\dots$ - janë pikët për secilin kriter të vlerësuar

Pikët për secilin kriter llogariten sipas formulës:

$$Pk1 = Vmink1 \times Pmaxk1 / Ok1$$

$Pk1$ _____ Pikët e kriterit që vlerësohet

$Vmink1$ Vlera më e ulët e kriterit që vlerësohet

$Pmaxk1$ Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet

Ok! Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet

III.1.2. Në dokumentat e tenderit, Seksioni 4.4, “Kriteret e përzgjedhjes së fituesit”, janë përcaktuar kriteret e vlerësimit si më poshtë:

A) Oferta ekonomisht më e favorshme, bazuar në kosto X

Sipas rëndësisë:

Çmimi më i ulët pikët 0- 60

Operatori ekonomik duhet të përshkruajë ofertën

Koha e zbatimit të kontratës, grafiku i zbatimit pikët 0- 30

Operatori ekonomik duhet të tregojë aftësinë për ti transformuar kërkesat e specifikimeve teknike dhe kostot në plan pune konkret, me qëllim për të realizuar shërbimet sipas afatit.

Cilësia pikët 0-10

Treguesit dhe analizë cilësorë në punë duke përcaktuar elementët e saj.

Autoriteti/Enti Kontraktor duhet të specifikojë pikët për secilin kriter të përcaktuar të vlerësimit.

OSE

B) oferta ekonomisht më e favorshme bazuar në çmim □

Në rastin e marrëveshjes së kuader, kur do të përdoret kriteri i vlerësimit të çmimit për njësi, për qëllime krahasimi, vlerësimi i ofertave të paraqitura do të bëhet në bazë të shumatores së çmimeve për njësi (Kjo, metodë vlerësimi nuk do të përdoret nga autoritetet/entet kontraktore kur sasitë janë të llogaritshme në bazë vjetore, sipas eksperiencës së mëparshme, dhe kur marrëveshja kuadër përdoret për prokurimin e mallrave dhe shërbimeve të vazhdueshme. Në këtë rast, çmimi i ulët do të vlerësohet me vlerën totale më të ulët të ofruar).

III.1.3. Në nenin 2 “Qëllimi i ligjit” të ligjit nr. 162/2021 “Për prokurimin publik” parashikohet se: Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

III.1.4. Në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr. 162/2021 “Për prokurimin publik” parashikohet se 1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.

III.1.5. Në nenin 87 “Kriteret për shpalljen e ofertës fituese” të ligjit nr. 162/2021 “Për prokurimin publik” parashikohet se:

1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë dhënien e kontratave publike bazuar në ofertën ekonomikisht më të favorshme.

2. Oferta ekonomikisht më e favorshme identifikohet në bazë të çmimit ose kostos, duke përdorur metodën e efektivitetit të kostos, siç janë kostot gjatë ciklit jetësor, në përputhje me nenin 88 të këtij ligji, dhe mund të bazohet në raportin më të mirë çmim-cilësi, që vlerësohet mbi bazën e kriterëve që lidhen me objektin e kontratës në fjalë, duke përfshirë cilësinë, aspektet mjedisore dhe/ose sociale.

Kritere të tilla mund të përfshijnë:

a) cilësinë, duke përfshirë meritat teknike, karakteristikat estetike dhe funksionale, aksesueshmërinë, projektimin për të gjithë përdoruesit, karakteristikat mjedisore dhe novatore, si dhe tregtimin dhe kushtet e tij;

b) organizimin, kualifikimin dhe përvojën e stafit që është emëruar për të zbatuar kontratën, kur cilësia e stafit të emëruar mund të ketë një ndikim domethënës në nivelin e zbatimit të kontratës; ose

c) shërbimin pas shitjes dhe asistencën teknike, kushtet e dorëzimit, si, për shembull, datën e dorëzimit, procesin e dorëzimit dhe periudhën e dorëzimit ose periudhën e përfundimit.

Elementi i kostos, gjithashtu, mund të marrë formën e një çmimi ose kostoje fikse, mbi bazën e të cilit operatorët ekonomikë do të konkurrojnë vetëm për kriteret e cilësisë.

3. Kriteret për shpalljen e kontratës fituese konsiderohen se janë të lidhura me objektin e kontratës, kur ato lidhen me punët, furnizimet ose shërbimet që do të ofrohen në zbatim të asaj kontrate në çdo drejtim dhe në çdo fazë të ciklit të tyre jetësor, duke përfshirë faktorët që bëjnë pjesë në:

a) procesin specifik të prodhimit, ofrimit ose tregtimit të atyre punëve, furnizimeve ose shërbimeve; ose

b) një proces specifik, për një fazë tjetër të ciklit të tyre jetësor, edhe kur këta faktorë nuk janë pjesë e substancës së tyre thelbësore.

4. Kriteret për shpalljen e kontratës fituese nuk i japin autoritetit ose entit kontraktor një liri të pakufizuar zgjedhjeje. Ato garantojnë mundësinë e konkurrencës efektive dhe shoqërohen nga specifikime, të cilat lejojnë që informacionet e dhëna nga ofertuesit të verifikohen për të

vlerësuar nëse ofertat përmbushin kriteret për shpalljen e kontratës fituese. Në rast dyshimi, autoritetet ose entet kontraktore verifikojnë saktësinë e informacionit dhe provat e paraqitura nga ofertuesit.

5. Autoriteti ose enti kontraktor specifikon në dokumentet e tenderit shkallën e rëndësisë relative që i jep çdo kriteri të zgjedhur për të përcaktuar ofertën ekonomikisht më të favorshme, me përjashtim të rasteve kur kjo identifikohet vetëm mbi bazën e çmimit.

Nëse përcaktimi i shkallës së rëndësisë nuk është i mundur për arsye objektive, autoriteti ose enti kontraktor i paraqet kriteret sipas rëndësisë në rend zbritës.

III.1.6. Në nenin 88 “Llogaritja e kostos gjatë ciklit jetësor” të ligjit nr. 162/2021 “Për prokurimin publik” parashikohet se:

1. Llogaritja e kostos gjatë ciklit jetësor mbulon, nëse është e mundur, të gjitha ose një pjesë të kostove të mëposhtme përgjatë ciklit jetësor të një produkti, shërbimi ose të punëve:

a) kostot që mbulohen nga autoriteti ose enti kontraktor ose nga përdorues të tjerë, si:

i. kostot që lidhen me blerjen;

ii. kostot e përdorimit, siç janë konsumi i energjisë dhe burime të tjera;

iii. kostot e mirëmbajtjes;

iv. kostot në fund të kohës së përdorimit, si kostot për grumbullim dhe riciklim.

b) kostot mbi efektet mjedisore dytësore që lidhen me produktin, shërbimin ose punët gjatë ciklit të tyre jetësor, me kusht që vlera e tyre monetare të mund të përcaktohet dhe të verifikohet. Këto kosto mund të përfshijnë koston e emetimit të gazeve me efekt serë dhe emetimeve të ndotësve të tjerë dhe kosto të tjera për zbutjen e ndryshimit klimatik.

2. Kur autoritetet ose entet kontraktore i vlerësojnë kostot duke përdorur metodën për llogaritjen e kostove të ciklit jetësor, ato përcaktojnë në dokumentet e tenderit të dhënat që duhet të ofrohen nga ofertuesit dhe metodën që do të përdorë autoriteti ose enti kontraktor për të përcaktuar kostot e ciklit jetësor, mbi bazën e këtyre të dhënave.

Metoda që përdoret për të llogaritur kostot mbi efektet mjedisore anësore duhet të përmbushë kushtet e mëposhtme:

a) bazohet mbi kritere objektivisht të verifikueshme dhe jodiskriminuese.

b) nëse nuk është krijuar për t'u zbatuar në mënyrë të përsëritur ose të vazhdueshme, metoda nuk favorizon ose diskriminon në mënyrë të padrejtë disa operatorë ekonomikë;

c) është e aksesueshme për të gjitha palët e interesuara;

ç) të dhënat e kërkuara mund të sigurohen pa vështirësi nga operatorët ekonomikë.

III.1.7. Neni 47 “Kriteret për shpalljen e ofertës fituese”, të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikon shprehimisht se:

1. Autoriteti/enti kontraktor përcakton dhënien e kontratave publike bazuar në ofertën ekonomikisht më të favorshme.

2. Oferta, ekonomikisht më e favorshme, identifikohet në bazë të çmimit ose kostos, duke përdorur metodën e efektivitetit të kostos, siç janë kostot gjatë ciklit jetësor, në përputhje me nenet 87 dhe 88 të LPP-së dhe mund të bazohet në raportin më të mirë çmim-cilësi, që

vlerësohet mbi bazën e kritereve që lidhen me objektin e kontratës në fjalë, duke përfshirë cilësinë, aspektet mjedisore dhe/ose sociale.

2.1. Për furnizimin me karburant, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje, në rastet kur oferta ekonomkisht më e favorshme bazohet në çmimin më të ulët, ky i fundit përlllogaritet bazuar në:

a) çmimin e bursës, lëvruar sipas kushtit CIF-Shqipëri, i cili dërgohet për publikim çdo javë nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave në Buletinin e Njoftimeve Publike;

b) elementet fiskale;

c) normën e fitimit të shprehur në vlerë absolute, e cila duhet të jetë e pandryshuar gjatë gjithë kohës së zbatimit të kontratës .

3. Për punët/mallrat/shërbimet që kanë specifikime të thjeshta, standarde teknike të mirënjohura dhe janë lehtësisht të gjendura në treg, oferta ekonomkisht më e favorshme, bazohet në çmimin si i vetmi element i ndryshueshëm ndërmjet ofertave.

4. Në kontratat që përveç çmimit për punën/mallin/shërbimin, objekt i kontratës, përmban dhe elemente të tjera, që kanë vlerë ekonomike dhe i ngarkojnë autoritetit/entit kontraktor shpenzime gjatë fazës së zbatimit të saj ose dhe më tej, kriteri i ofertës ekonomkisht më të favorshme bazohet në:

a) cilësinë, duke përfshirë meritat teknike, karakteristikat estetike dhe funksionale, aksesueshmërinë, projektimin për të gjithë përdoruesit, karakteristikat mjedisore dhe novatore, si dhe tregtimin dhe kushtet e tij; dhe/ose

b) organizimin, kualifikimin dhe përvojën e stafit që është emëruar për të zbatuar kontratën, kur cilësia e stafit të emëruar mund të ketë një ndikim domethënës në nivelin e zbatimit të kontratës; dhe/ose

c) shërbimin koston pas shitjes dhe asistencën teknike, kushtet e dorëzimit, si p.sh. datën e dorëzimit, procesin e dorëzimit dhe periudhën e dorëzimit ose periudhën e përfundimit.

5. Kriteret për shpalljen e kontratës fituese konsiderohen se janë të lidhura me objektin e kontratës, kur ato lidhen me punët, furnizimet ose shërbimet që do të ofrohen në zbatim të asaj kontrate në çdo drejtim dhe në çdo fazë të ciklit të tyre jetësor, duke përfshirë faktorët që bëjnë pjesë në:

a) procesin specifik të prodhimit, ofrimit ose tregtimit të atyre punëve, furnizimeve ose shërbimeve; ose

b) një proces specifik, për një fazë tjetër të ciklit të tyre jetësor, edhe kur këta faktorë nuk janë pjesë e substancës së tyre thelbësore.

6. Kriteret për shpalljen e kontratës fituese garantojnë mundësinë e konkurrencës efektive dhe shoqërohen nga specifikime, të cilat lejojnë që informacionet e dhëna nga ofertuesit, të verifikohen, për të vlerësuar nëse ofertat përmbushin kriteret për shpalljen e kontratës fituese. Në rast dyshimi, autoriteti/enti kontraktor verifikon saktësinë e informacionit dhe provat e paraqitura nga ofertuesit.

7. Autoriteti/enti kontraktor specifikon në dokumentet e tenderit shkallën e rëndësisë relative që i jep çdo kriteri të zgjedhur për të përcaktuar ofertën ekonomkisht më të favorshme, me përjashtim të rasteve kur kjo identifikohet vetëm mbi bazën e çmimit.

8. Të gjitha kriteret e vendosura për vlerësimin e ofertave duhet të jenë sa më objektive dhe të shprehen në shifra. Në çdo rast, kur kriteret janë më shumë se një, pesha e kriterit të çmimit nuk do të jetë më pak se 50 pikë. Pikët maksimale që do të marrë një ofertë do të jenë 100 pikë.

III.1.8. Në përmbushje të kriterëve vlerësues për të cilat është përcaktuar dhe pesha specifike, bashkimi i operatorëve ekonomikë “*L.T.E Construction*” SHPK & “*Varaku E*” SHPK ka paraqitur në sistemin e prokurimit elektronik SPE, ndër të tjera edhe dokumentacionin si më poshtë:

- 1- Ofertë ekonomike në vlerën 51.823.332,23 lekë pa tvsh.
- 2- Grafikon e Punimeve me afat realizimi 5 muaj.
- 3- Grafikon e Punimeve dhe Metodologjinë.

III.1.9. Referuar bazës ligjore të sipërcituar dhe kriterëve të vlerësimit të përcaktuara në dokumentat e tenderit parashikohet se procedura e prokurimit objekt ankimi për përcaktimin e ofertës ekonomike më të favorshme i nënshtrohet vlerësimit të 3 (katër) kriterëve të vlerësimit, të cilat janë çmimi i ofertës ekonomike, koha e zbatimit të kontratës grafiku zbatimit dhe cilësia.

Vlerësimi i ofertave përta i përket kriterit të vlerësimit bazuar çmimin e ofertës, të paraqitura nga operatorët ekonomikë “*LTE Construction*” SHPK & “*Varaku E*” SHPK dhe “*HTM*” SHPK & “*Vildev-Co*” SHPK pjesëmarrës dhe të kualifikuar në këtë procedurë të bërë duke marrë për bazë ofertën ekonomike të dhëna nga ana e tyre sipas Shtojcës 1 “*FORMULARI I OFERTËS EKONOMIKE*”, si më poshtë:

- 1- BOE “*LTE Construction*” SHPK & “*Varaku E*” SHPK ka deklaruar çmimin 51.823.332,23 lekë pa TVSH
- 2- BOE “*HTM*” SHPK & “*Vildev-Co*” SHPK ka deklaruar çmimin 54.450.706 lekë pa TVSH.

III.1.10. KPP vlen të sqarojë se referuar kriterëve të vlerësimit të përcaktuar në pikën 4.4 të seksionit 4 të dokumentave të tenderit autoriteti kontraktor ka përcaktuar së në rastin e vlerësimit të ofertëve të përmendura më sipër përta i përket kriterit të çmimit të ofertës është përcaktuar se oferta ekonomike e cila ka çmimin më të ulët do të vlerësohet me 60 (gjashtëdhjetë) pikë, ndërsa referuar seksionit I “Udhëzim Për Operatorët Ekonomik” në të cilën ofertat ekonomike me vlerë më të lartë do të vlerësohen me pikë sipas formulës.

Në rastin konkret, KPP gjen me vënd të sqarojë se referuar informacionit të autoritetit kontraktor, si dhe verifikimeve të kryera në sistemin e prokurimeve elektronik (SPE) konkretisht dhe raport auditit oferta ekonomike më e ulët është oferta e shoqërisë “*LTE Construction*” SHPK & “*Varaku E*” SHPK e cila nga ana e komisionit të vlerësimit të ofertave në mënyrë jo të drejtë në raport audit nuk është vlerësuar me 60 (gjashtëdhjetë) pikë ose 100% përta i përket kriterit të vlerësimit bazuar në çmim, përta kohë që është dhe oferta më e ulët, në respektim të parashikimeve ligjorë të sipërcituara oferta ekonomike më e ulët automatikisht vlerësohet me pikët maksimale të përcaktuara në kriter pra 60 pikë ose 100%, ndërsa oferta ekonomike e shoqërisë “*HTM*” SHPK & “*Vildev-Co*” SHPK meqënëse është ofertë ekonomike më e lartë se oferta e shoqërisë “*LTE Construction*” SHPK & “*Varaku E*” SHPK është vlerësuar me pikë duke zbatuar formulën ku nga zbatimi i kësaj formule me të drejtë është vlerësuar me 57 pikë ose 95 % përta i përket kriterit të vlerësimit bazuar në çmim, ndërkohë që në raport audit është vlerësuar nga të tre anëtarët e komisionit me 97%, në kundërshtim më atë cka është

pasqyruar në procesverbalin e vlerësimit. Gjithashtu konstatohet se Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nuk ka pasqyruar në mënyrë të drejtë pikët për secilin kriter të vlerësuar si në proceverbalin e vlerësimit me nr. 1135/1 prot, datë 12.03.2024, ashtu dhe në rraport auditin në sistemin e prokurimit elektronik, pasi vërehen mospërputhje të sasisë së pikëve, përsa i përket kriterëve kualifikuese të dhëna në procesverbal me ato të pasqyruara ne rraport audit. Komisioni Vlerësimit të Ofertave duhet të marrë masa dhe të korrigjojë shkeljet e konstatuara dhe pasqyruar të njëjtat pikë në rraportin e audit në sistemin e prokurimit elektronik me pikët e pasqyruara në proceverbalin e vlerësimit me nr. 1135/1 prot, datë 12.03.2024, të mbajtur nga Komisioni Vlerësimit të Ofertave dhe të miratuar nga titullari i autoritetit kontraktor. Komisioni i Prokurimit Publik, sqaron se, ndonëse vlerësimi me pikë bazohet në gjykimin personal dhe individual të secilit prej anëtarëve të komisionit të vlerësimit të ofertave, brenda diapazonit me pikë, të përcaktuar në dokumentat e tenderit, por nga ana tjetër ky vlerësim dhe gjykim, nuk duhet të jetë subjektiv, por i bazuar dhe arsyetuar mbi dokumentacionin e paraqitur nga secili operator ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, Komisioni, gjykon se, procesi i pikëzimit, duhet të bëhet në përputhje dhe në proporcion me dokumentacionin e paraqitur nga secili ofertues, i cili, nga ana tjetër, duhet të jetë sa më afër kërkesave dhe kriterëve të përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit. Fryma e ligjit të prokurimit publik, është e tillë që, çdo operator duhet të përgatisë ofertën e tij në përputhje me kriteret dhe kërkesat e parashikuara në dokumentat e tenderit.

Gjithashtu referuar vlerësimit me pikë përsa i përket kriterit të dytë afatit kohor të parashikuar në dokumentat standarte të tenderit rezulton se autoriteti kontraktor ka përcaktuar afatin prej 5 muaj për realizimin e kontratës, dhe këtij kriteri i ka vendosur 0-30 pikë. Komisioni i Prokurimit Publik referuar vlerësimit të kryer nga autoriteti kontraktor konstaton se operatori ekonomik ankimes për këtë kriter është vlerësuar me 24 pikë ose 80 %, ndërkohë që në analizë të dokumentacionit të dorëzuar nga bashkimi operatorëve ekonomikë “*LTE Construction*” SHPK & “*Varaku E*” SHPK konstaton se në lidhje me komponentin e grafikut të punimeve ka paraqitur dokumentacionin “*Grafik Punimesh*” në të cilin ka përcaktuar se afati për realizimin e kontratës do të jetë 5 muaj, ndërkohë nga ana tjetër duke ju referuar përmbushjes së këtij kriteri nga operatori tjetër ekonomik pjesëmarrës “*HTM*” SHPK & “*Vildev-Co*” SHPK rezulton se ky i fundit ka dorëzuar në SPE një deklaratë ku ndër të tjera deklorohet se “*punimet për realizimin e këtij objekti do të përfundojnë brenda afatit të përcaktuar nga autoriteti kontraktor (në rast të shpalljes fitues)*”, referuar kësaj deklarate nuk është përcaktuar afati në mënyrë koncize, por është shprehur se realizimi i punimeve do të kryhet brenda afatit kohor të përcaktuar nga AK, i cili është 5 muaj. Komisioni gjykon se procesi i pikëzimit në rastin konkret përsa i përket kriterit të grafikut të punimeve nuk është bërë në përputhje dhe në proporcion me dokumentacionin e paraqitur nga ofertuesi. Përsa kohë që të dy operatorët ekonomik kanë deklaruar se afatin e realizimit të punimeve do ta kryejnë për 5 muaj sa është dhe afati i përcaktuar nga autoriteti kontraktor, atëherë të dy këta operatorë do të duhej të vlersoheshin me pikë të barabartë dhe jo diferencuese sikurse ka vepruar KVO në rastin konkret. Fryma e LPP është e tillë që çdo operator duhet të përgatisë ofertën e tij në përputhje me kriteret dhe kërkesat e parashikuara në dokumentat e tenderit. Në rastin konkret kriteri i përcaktuar nga autoriteti kontraktor për “*Grafikun e Realizimit të Punimeve*” është plotësuar

në makismumin e mundshëm nga të dy operatorët ekonomik pjesëmarrës ndaj duhej të trajtoheshin me pikë të barabartë të dy operatorët, ndaj rrjedhimisht pretendimi i ankimuesit për një pikëzim maksimal lidhur me këtë komponent është i justifikuar. Komisioni i Prokurimit Publik, sqaron se, ndonëse vlerësimi me pikë bazohet në gjykimin personal dhe individual të secilit prej anëtarëve të komisionit të vlerësimit të ofertave, brenda diapazonit me pikë, të përcaktuar në dokumentat e tenderit, por nga ana tjetër ky vlerësim dhe gjykim, nuk duhet të jetë subjektiv, por i bazuar dhe arsyetuar mbi dokumentacionin e paraqitur nga secili operator ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, Komisioni, gjykon se, procesi i pikëzimit, duhet të bëhet në përputhje dhe në proporcion me dokumentacionin e paraqitur nga secili ofertues, i cili, nga ana tjetër, duhet të jetë sa më afër kërkesave dhe kriterëve të përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit. Fryma e ligjit të prokurimit publik, është e tillë që, çdo operator duhet të përgatisë ofertën e tij në përputhje me kriteret dhe kërkesat e parashikuara në dokumentat e tenderit.

Për sa më sipër pretendimi i bashkimit të operatorëve ekonomik ankimues “*LTE Construction*” SHPK & “*Varaku – E*” SHPK qëndron.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023 “*Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik*”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “*Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “*Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19*”, Komisioni i Prokurimit Publik njëzëri,

Vendos:

1. Të pranojë ankesën e paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “*L.T.E Construction*” SHPK & “*Varaku E*” SHPK për procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur*”, me Nr. REF-92191-12-27-2023, me objekt “*Rehabilitimi i rrugëve në lagjen Metallaj, Karpen, Bodinok Nj. Ad Maminas*” me fond limit: 55.343.180 (pesë milion e treqind e dyzetë e tre mijë e njëqind e tetëdhjetë) lekë pa TVSH, parashikuar për tu zhvilluar në datën 19.01.2024 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Shijak.
2. Autoriteti kontraktues të kryejë rivlerësimin e procedurës së mësipërme në zbatim të konstatimeve të bëra nga Komisioni i Prokurimit Publik në këtë vendim.
3. Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.

4. Ngarkohet zyra e financës, që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “*L.T.E Construction*” SHPK & “*Varaku E*” SHPK.
 5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
 6. Kopje e këtij vendimi, i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Fiorent Zguro

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Gjergj Mersini

Kryetar
Jonaid Myzyri

